

Roli i ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Manjola Veizi
27 Shkurt 2021

Mosmarrëveshjet janë pjesë e pashmangshme e te jetuarit se shoqërise. Kjo ka sjelle nevojën e zhvillimit të praktikave shoqërore dhe institucioneve e mjeteve juridike efektive në zgjidhjen e tyre. Nder me të përdorurat në shoqëritë e sotme demokratike listojme.




Negociimi
Ndermjetesimi
Arbitrazhi
Procesi Gjyqësor

ALTERNATIVAT E ZGJIDHJES SE MOSMARREVESHJEVE

Ndryshimet midis Negociimit, Ndermjetesimit, Arbitrazhit, dhe Procesit Gjyqesor, A

Palet= P

Negociimi



ALTERNATIVAT E ZGJIDHJES SE MOSMARREVESHJEVE

Ndryshimet midis Negociimit, Ndermjetesimit, Arbitrazhit, dhe Procesit Gjyqesor, A


Palet= P

Ndermjetesimi

Ndermjetesuesi

P1

P2




ALTERNATIVAT E ZGJIDHJES SE MOSMARREVESHJEVE

Ndryshimet midis Negociimit, Ndermjetesimit, Arbitrazhit, dhe Procesit Gjyqesor, A

Palet= P

Arbitrazhi dhe Procesi Gjyqesor



Ndermjetesimi
nje menyre
efikase dhe e
leverdishme per
zgjidhjen e
mosmarreveshje
ve

cfare perfitojme me shume nga kjo menyre ?

- Zhvillohet jashtegjyqesisht
- Zhvillohet ne ambient privat
- Nuk kerkon procedure te caktuar
me kerkon me pak ose aspak burime
financiare
- Palet vendosin vete me vullnet te lire per
zgjidhjen e mosmarreveshjes se tyre
- Minimizon vazhdimin e nje situate
konfliktuale midis paleve

“Ndërmjetësimi është një proces i strukturuar dhe ndërveprues jashtegjyqësor,, ku një palë e tretë e paanshme ndihmon palët në mosmarrëveshje në zgjidhjen e konfliktit përmes përdorimit të teknikave të specializuara të komunikimit dhe negocimit”



Rolet e ndërmjetësuesit gjatë procesit të ndërmjetësimit

- a) Shpresëdhënia dhe inkurajimi i palëve për të arritur një zgjidhje të përshtatshme
- b) Krijimi i Një Ambienti të Sigurtë për palët në proces
- c) Fuqizimi i Palëve në Proces
- d) Krijimi i Kanaleve të Komunikimit
- e) Lehtësimi i Negociatave
- f) Vlerësimi Objektiv i Zgjidhjes të Mundshme të Mosmarrëveshjes
- g) Paanshmeria në Gjykimin e Mosmarrëveshjes

1. Shpresëdhënës

Palët shpesh hynë në ndërmjetësim duke u ndjerë të pashpresë dhe skeptikë mbi zgjidhjen e probleme te tyre.

Siguria e një ndërmjetësi se konflikti dhe zgjidhja janë kushte natyrore, dhe që palët zotërojnë burimet dhe aftësitë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre, do të fillojë t'u japë palëve besim në veten e tyre dhe zgjidhjen e procesit.

2. Krijimi i një ambienti të sigurtë

Ndërmjetësi përpiqet të krijojë një hapësirë të sigurt ku pjesëmarrësit të mund të ndjehen mjaftueshëm rehat për të eksploruar problemet e tyre dhe për të shprehur dëshirat dhe nevojat e tyre. Kjo kërkon shume perkushtim nga ana e tij, për të kuptuar dhe mbështetur në mënyrë të paanshme gjendjen emocionale të palëve në proces.

3. Fuqizimi i Palëve në proces

- Ndërmjetësi mbështet secilën palë në marrjen e vendimeve në secila fazë e procesit. Vetë-vendosmëria e palëve është pjesa më e rëndësishme e procesit

4. Krijimi i Kanaleve të Komunikimit

Kur palët nuk flasin me njëra-tjetrën, ndërmjetësi ndërhyr për të rivendosur komunikimin. Ndonjëherë palët flasin por ata nuk kuptojnë njëri-tjetrin. Ata mund të mos jenë të vetëdijshëm për disa fakte që pala tjetër posedon. Ata gjithashtu mund të kenë perceptime të ndryshme për kuptimin e situates. Këtu ndërmjetësi mund të veprojë si një përkthyes dhe transmetues i informacionit

5. Lehtësimi i Negociatave

Ndërmjetësi lehtëson procesin e ndërmjetësimi nga strukturimi i diskutimeve rreth një axhende të temave për të cilat palët kanë rënë dakord për, përcaktimin e nevojave ose interesave themelore të tyre dhe pastaj duke i ndihmuar ata të eksplorojnë një larmi opsionesh që përmbushin ato nevoja.

Ata e bëjnë këtë falë një dëgjimi të përqendruar, të qenit i vëmendshëm ndaj gjuhës së trupit dhe energjisë së percjellur,, duke reflektuar dhe parafrazuar përsëri emocionet dhe përmbajtjen, inkurajuar, mbështetur dhe mbajtur një balance paanshmerie gjate gjithë procesit te ndërmjetësimi.

6. Vlerësim objektiv te zgjidhjeve te mundshme të mosmarrëveshjes

Ndërmjetësi është i interesuar në qëndrueshmërinë e çdo marrëveshje te negociuar , dhe duhet të shqyrtojë e sqaroje me secilën palë nëse ato realisht mund të përmbushin kushtet e marrëveshjes se propozuar. Kjo arrihet më së miri duke bërë pyetje të hapura dhe prova.

7. Paanshmeria në gjykimin e mosmarrëveshjes

Parimi kryesor në të cilin bazohet detyra e a e ndërmjetësit është paanshmeria. Ndermjetesi duhet të zhvishet nga gjykimi subjektiv dhe të jetë sa më objektiv në zgjidhjen që do të keshillojë palëve.

Mund të ketë raste në ndërmjetësim kur ndërmjetësimi nuk është i nevojshëm. Nëse është kështu, në duhet të ndalojmë së foluri dhe të lëmë palët të vijojnë komunikimin deri në momentin që lehtësimi ynë do të jetë përsëri i dobishëm.

Ndermjetesimi si mjet Juridik ne Legjislacionin shqiptar

LIGJ Nr.10 385, datë 24.2.2011, njohu per here te pare si institucion juridik Ndermjetesimin dhe rregulloi funksionimin e tij duke percaktuar qarte te drejtat e detyrimet e Ndermjetesuesit .

Ligji ka pesuar ndryshime gjate viteve te fundit , respektivisht me ligjin nr. 81/2013, datë 14.2.2013, nr. 26/2018, datë 17.5.2018, dhe eshte plotesuar e harmonizuar me kuadrin ligjor Nderkombetar

Të Drejtat e Ndërmjetësuesit

Ndërmjetësit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët.

Ndërmjetësi i përzgjedhur nga palët në mosmarrëveshje nuk është i detyruar të lidhë marrëveshje ndërmjetësimi. Në këtë rast, ndërmjetësi nuk është i detyruar të arsyetojë vendimin e tij.

Detyrimet e Ndërmjetësuesit

Ndërmjetësi e ushtron profesionin e vet në mënyrë të paanshme, me ndershmëri dhe profesionalizëm, respekton rregullat e etikës profesionale dhe përdor të gjitha mjetet e ligjshme për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve.

Ndërmjetësi nuk ofron këshillim ligjor.

Ndërmjetësi ruan konfidencialitetin për të dhënat, për të cilat ka dijeni për shkak të një procedure ndërmjetësimi, në raport me secilën prej palëve apo me persona të tjerë jashtë procedurave të ndërmjetësimit, me përjashtim të rastit kur pala, të dhënat e së cilës bëhen publike ose përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dhënë miratimin e saj me shkrim.

Detyrimet e Ndërmjetësuesit

Ndërmjetësi ruan sekretin profesional dhe nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte dhe rrethana, për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit, përveç rastit kur jepet pëlqimi me shkrim nga të gjitha palët në ndërmjetësim.

Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ndërmjetësi nuk duhet të veprojë si arbitër për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka qenë ose është subjekt i procedurave të ndërmjetësimit ku ka qenë ndërmjetës, ose për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje tjetër, që rrjedh nga e njëjta marrëdhënie, e cila i është nënshtruar procedurës së ndërmjetësimit.

Me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

Konflikti i interesit

Ndërmjetësi siguron që ndërmjet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.

2. Konsiderohet se ka konflikt interesash kur:

- a) ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;
- b) ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njërës prej palëve;
- c) ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërën prej palëve
- d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

Detyrimet e Ndërmjetësuesit

Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ai duhet të deklarojë, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që ndërmjetësohet.

Ndërmjetësi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij

Konflikti i interesit

Ndërmjetësi siguron që ndërmjet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.

2. Konsiderohet se ka konflikt interesash kur:

- a) ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;
- b) ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njërës prej palëve;
- c) ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërën prej palëve
- d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

Radhe ndodh qe palet dalin te kenaqur nga nje proces gjyqesor. Ndermjetesimi ju jep mundesine te sqaroni situaten tuaj dhe te gjeni vete zgjidhjen. Ne cdo suate konfliktuale , ruani qetesine dhe ndermjetesoni !

Ju Faleminderit!